



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/84
Datë: 01.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 83 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/84
Datë: 01.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Formohet Komitetit Bashkërendues Ndërministror për Administrimin e Tokës në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme Komiteti)
2. Komitetit kryesohet nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike apo përfaqësuesi që e emëron Ministri.
3. Anëtar të Komitetit do të jenë përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe nga Zyra e Kryeministrit.
4. Në përbërje të Komitetit do të hyjnë: Kryeshefi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe Drejtori i Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
5. Obligohen institucionet e lartë shënuara që në afatin prej 8 ditës, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të caktojnë përfaqësuesit e tyre për anëtar të Komitetit dhe për këtë ta informojnë Qeverinë.
6. Punët dhe detyrat e Komitetit janë përshkruar në projekt-propozimin për formimin e tij, bashkangjitur këtij vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

PROJEKT PROPOZIMI

PËR

FORMIMI E KOMITETIT NDËR-MINISTROR PËR ADMINISTRIM TË TOKËS NË FUSHËN E ADMINISTRIMIT TË TOKËS DHE INFRASTRUKTURËS SHETËRORE TË TË DHËNAVE HAPËSINORE (National Spatial Data Infrastructure - NSDI)

I prezantohet Qeverisë së Republikës së Kosovës propozimi për procedura të mëtutjeshme të aprovimit të formimit të Komitetit Ndër-Ministror për Administrim të Tokës në fushën e Administrimit të Tokës dhe Infrastrukturës Shtetërore të të Dhënave Hapësinore (NSDI).

Formimi i Komitetit Ndër-Ministror për Administrim të Tokës, është një veprim i cili është prezantuar në Planin e Biznesit për Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe zhvillimin e Sektorit të Kadastrit 2009-2014, i cili është aprovuar nga Qeveria (Nr. i Vendimit 05/07, Data: 25.06.2009).

Bashkëpunimi dhe koordinimi në mes të akterëve të involvuar është një strategji e qartë dhe e nevojshme, kur zhvillohet administrimi i tokës. Fushat për të cilat duhet të ketë bashkëpunim dhe koordinim janë: Kadastrit dhe sistemi i informatave të tokës, taksa mbi pronën e paluajtshme, funksionimi i sistemit të hipotekave, përmirësimi i planifikimit urbanistik dhe zhvillimi i infrastrukturës, mbështetja për menagjimin e mjedisit, si dhe mbrojtja dhe prodhimi i të dhënave statistikore për të ndihmuar planifikimin ekonomik dhe zhvillimor.

Ky komiteti duhet të luaj një rol këshillues ndaj Qeverisë dhe AKK-së për të gjitha çështjet që ndërlidhen rreth administrimit të tokës dhe NSDI. Ky komitet gjithashtu duhet të koordinoj dhe monitoroj të gjitha iniciativat brenda fushës së administrimit të tokës dhe NSDI për të siguruar ndërlidhje dhe promovim të interesave nacionale, komunale si dhe të sektorit privat dhe promovim të çështjeve specifike për bashkëpunim dhe partneritet publiko-privat (PPP); dhe diskutime tjera lidhur me çështje të interesit të përbashkët të anëtarëve, p.sh. Kadastrit dhe regjistrimi i pasurisë së paluajtshme; komiza ligjore dhe implementimi i ligjeve; kualiteti dhe çmimet e shërbimeve dhe produktet; aftësitë dhe trajnimet; si dhe zhvillimi, mirëmbajtja dhe bashkëpunimi lidhur me sistemet teknike siç është Sistemi i Informatave të Kadastrit të Tokës së Kosovës (SIKTK/KCLIS).

Anëtarët e Komitetit duhet të caktohen nga Qeveria. Grupet e caktuara punuese për çështje specifike duhet të formohen që të jenë në dispozicion të këtij Komitetit, ku anëtarë të këtyre grupeve duhet të jenë përfaqësues nga qeveria, komunat dhe sektori privat.

Anëtarë të Komitetit janë përfaqësues nga Ministria e Administratës Publike, Ministria e Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe nga Zyra e Kryeministrit. Ministria e Pushtetit Lokal do t'i përfaqësoj komunat dhe mund të mbështetet edhe nga anëtar që përfaqësojnë Komunat e përzgjedhura. Preferohet që Komiteti të drejtohet nga Ministri i Ministrisë së Administratës Publike.

Sekretariati i këtij Komitetit duhet të sigurohet nga ana e Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK).

Komiteti Ndër-Ministror për Administrim të Tokës duhet të ketë të drejtë vendim-marrje për disa çështje në emër të Qeverisë. Sugjerohet që ky Komitet duhet të jetë një organ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për politikë-bërje me të drejtë vendim-marrje sa i përket implementimit të Strategjisë dhe Planit të Biznesit të AKK-së duke përfshirë edhe Programin Zhvillimor.

Funksionet e Komitetit Ndër-Ministror për Administrim të Tokës të ndërlidhura me Strategjinë dhe Planin e Biznesit duke e përfshirë edhe Programin Zhvillimor janë:

- Udhëheqje dhe vendim-marrje strategjike për të gjitha çështjet dhe politikat në parim;

- Identifikimi i politikave dhe çështjeve strategjike;
- Monitorimi i implementimit të Strategjisë së AKK-së, Planit të Biznesit dhe reformave në politika;
- Koordinimi dhe krijimi i konsensusit në mes të të gjithë akterëve të involvuar për çështjet e politikave kritike që ndërlidhen me implementimin dhe sigurimin e koordinimit në mes të këtyre akterëve.

Prandaj, kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që:

- ♦ Të formoj Komitetin Ndër-Ministror për fushën e administrimit të tokës dhe NSDI; dhe kështu të zëvendësoj PPE 136, Veprimi 8 i prezantuar në PVPE.
- ♦ Ta fuqizoj Komitetin me vendim-marrje për çështjet mbi politikën në parim që ndërlidhen me Strategjinë dhe Planin e Biznesit të AKK-së duke përfshirë Programin Zhvillimor; dhe
- ♦ T'i jap përgjegjësi Ministrisë së Administratës Publike që të vendos për Termat e Referencës për formimin e këtij Komiteti Ndër-Ministror në marrëveshje me akterët tjerë të involvuar, dhe ta zbatoj më tutje këtë vendim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/84

Datë: 01.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Miratohet Projektligji për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Besueshmërisë.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/84
Datë: 01.10.2009

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 tetor 2009, mori

V E N D I M

1. Komitetit të Grave të Verbra të Kosovës i ndahen mjete financiare në vlerë prej 3.360 (tremijetreqindegjashtëdhjetë) euro.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi sigurohen nga Programi Shpenzimet e Paparashikuara, kategoria ekonomike, Rezervat, dhe barten në llogarinë rrjedhëse të Komitetit të Grave të Verbra, Nr. 140100000912464 Banka Ekonomike e Kosovës.
3. Obligohet Ministria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë